



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 19 maj 2011
Nr. ref.:RK124/11

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 22/11

Parashtrues

Bojana Denić

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe
Parashtrës, A. Nr. 263/2010, të 12 nëntorit 2010**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruese është znj. Bojana Denić, nga Parteshi, të cilën e përfaqëson avokati Bejtush A. Isufi nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e konteston vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësja, A. Nr. 263/2010, të 12 nëntorit 2010, me të cilin i është refuzuar ankesa kundër vendimit të Komisionit Qendror Zgjedhor, të regjistruar si 757/10, lidhur me mandatet e subjektit politik Lista e Bashkuar Serbe.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesja e konteston vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësja, A. Nr. 263/2010, duke konsideruar se me të janë shkelur neni 3.2, neni 21.3 dhe neni 45.1 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe neni 111 i Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Baza juridike

4. Neni 113.7 dhe 21.4 i Kushtetutës, nenet 20, 22.7 dhe 22.8 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe rregulli 56 (2) i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Parashtruesja e parashtrroi kërkesën pranë Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) më 21 shkurt 2011.
6. Më 24 mars 2011, Gjykata Kushtetuese e njoftoi z. Bejtush A. Isufi se procedura është iniciuar dhe se lënda është regjistruar nën Nr. 22-11.
7. Po të njëjtën ditë, Gjykata Kushtetuese e njoftoi Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësja, si dhe Komisionin Qendror Zgjedhor, se lënda është regjistruar nën Nr. 22-11 dhe se është iniciuar procedura për vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimeve të tyre.
8. Më 19 maj 2011, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit Kadri Kryeziu Kolegji Shqyrtues i përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Ivan Čukalović, i propozoi Gjykatës së plotë refuzimin e kërkesës si të papranueshme.

Përmbledhja e fakteve

9. Ankuesja Bojana Denić, si kandidate e Listës së Bashkuar Serbe për këshilltare të Kuvendit Komunal të Parteshit, fitoi 15 vota dhe ishte e 3-ta në listën e kësaj partie politike.
10. Jasmina Vasić, nga e njëjta parti politike, Lista e Bashkuar Serbe, fitoi 15 vota, si Bojana Denić, mirëpo ajo ishte e 9-ta në listë.
11. Komisioni Qendror Zgjedhor në Prishtinë në njoftimin e 16 korrikut 2010, me numër të protokollit Nr. 757-10, dhe të nënshkruar nga kryetari i KQZ-së, e caktoi znj. Jasmina Vasić anëtare të Kuvendit Komunal dhe e refuzoi kërkesën e znj. Bojana Denić për konfirmim dhe verifikim të mandatit të saj për anëtare të Kuvendit Komunal të Parteshit.
12. E pakënaqur me këtë vendim, Bojana Denić parashtrroi ankesë pranë KQZ-së e cila e hodhi poshtë këtë ankesë me arsyetimin se kinse ky vendim është përfundimtar dhe se

pala e pakënaqur ka të drejtë të iniciojë kontest administrativ pranë Gjykatës Supreme në Prishtinë.

13. E pakënaqur me vendimin e Komisionit Qendror Zgjedhor, Bojana Denić u ankua pranë Gjykatës Supreme të Kosovës me kërkesë që të anulohet vendimi i Komisionit Qendror Zgjedhor. Mirëpo, Gjykata Supreme e hodhi poshtë këtë ankesë me arsyetimin se së pari duhet drejtuar Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa.
14. Në përputhje me rekomandimin e Gjykatës Supreme, më 15 nëntor 2010, Bojana Denić parashtroi ankesë në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa përmes të cilës kërkon të ndryshohet vendimi i Komisionit Qendror Zgjedhor, Nr. 757-10 dhe të konfirmohet se ajo është anëtare e Kuvendit Komunal të Parteshit.
15. Mirëpo, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa e refuzoi ankesën si të papranueshme me arsyetimin se *“Rezultatet e zgjedhjeve janë përfundimtare dhe të obligueshme atëherë kur të certifikohen nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”*.

Pretendimet e parashtruesit

16. Parashtruesja pretendon se me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa me të cilin është refuzuar kërkesa që Bojana Denić të futet në listën e anëtarëve të Kuvendit Komunal të Parteshit, i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 3.2, 21.3 dhe 45.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
17. Për më tepër, parashtruesja pretendon se me një vendim të tillë është bërë shkelje e të drejtave të parapara me nenin 111 të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Ligji për zgjedhjet në Kosovë

18. Ligji për mbajtjen e zgjedhjeve në Republikën e Kosovës rregullohet me Ligjin Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Ligjin Nr. 03/L-256 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme, dhe me Ligjin Nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës.
19. Sipas Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Ligjit Nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, neni 26 i Ligjit për Zgjedhjet Lokale parasheh si në vijim:

„Kreu XVI (Procesi i numërimit të fletëvotimeve dhe shpallja e rezultateve të zgjedhjeve) i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës vlen mutatis mutandis për zgjedhjet lokale përveç nëse përcaktohet ndryshe me anë të këtij ligji “.

20. Neni 101 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme parasheh dispozita të përgjithshme për numërimin e fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të zgjedhjeve dhe e autorizon KQZ-në që të vendosë rregulla në pajtim me të. I njëjti nen thotë si në vijim:

101.1 Procedurat e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparenca, efikasiteti, mundësia për rinumërimin dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës.

101.2 Fletëvotimet e rregullta nga vendvotimet përbrenda Kosovës numërohen në po ato vendvotime, menjëherë pas mbylljes së procesit votues.

101.3 Procedurat e numërimit janë në pajtim me rregullat e KQZ-së.

21. KQZ-ja ka vendosur rregulla që përcaktojnë shumë aspekte të zgjedhjeve. Rregulli i tillë i parë ka qenë rregulli zgjedhor Nr. 01/2008 për regjistrimin dhe veprimin e partive politike, i cili hyri në fuqi më 29 qershor 2009. Rregulli i fundit ka qenë rregulli zgjedhor Nr. 15/2010 në lidhje me zgjedhjet e parakohshme dhe të jashtëzakonshme, i cili hyri në fuqi më 2 mars 2010.

22. Rregulli më i rëndësishëm i vendosur, që ndërlidhet me këtë rast, është Rregulli zgjedhor Nr. 09/2009 për votimin dhe numërimin brenda vendvotimeve në nivel të Komisionit Komunal Zgjedhor, i cili hyri në fuqi më 25 qershor 2009. Këto rregulla kanë të bëjnë proceset e numërimit të fletëvotimeve, si dhe me numërimin dhe përputhjen e fletëvotimeve me kusht. KZAP-i i zgjidh ankesat në lidhje me procesin e votimit. Parashtruesja ka parashtruar ankesë në KZAP dhe ankesa e saj është hedhur poshtë nga KZAP-i.

23. Neni 106 i Ligjit Nr. 03/L-256 për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme, përcakton si në vijim:

“KQZ-ja certifikon rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve, pas përfundimit të të gjitha procedurave në vendvotime dhe qendrat e numërimit, si dhe kur të gjitha ankesat që u përkasin votimit dhe numërimit të vendosura nga PZAP-i dhe çdo apel ndaj vendimeve të PZAP-it lidhur me to, të jetë vendosur nga Gjykata Supreme e Kosovës”.

24. Neni 118.4 i Ligjit Nr. 03/L-256 për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme, parasheh si vijon:

“Mund të apelohe vendimi i PZAP-it, sikurse që PZAP-i mund të rishikojë cilindo nga vendimet e marra, pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar. Ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzet e katër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesë mijë (5.000) Euro, ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore. Gjykata Supreme vendos në afatin prej shtatëdhjetë e dy (72) orëve pas paraqitjes së apelit”.

25. Neni 118.5 i Ligjit Nr. 03/L-256 dhe Ligji për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme, parasheh:

“Vendimi i PZAP-it është i detyrueshëm për t’u zbatuar nga KQZ-ja, përveç në rast se apeli i lejuar parashtrohet brenda kohës së paraparë dhe Gjykata Supreme përcakton ndryshe”.

Vlerësimi paraprak i pranueshmërisë

26. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të punës së Gjykatës Kushtetuese.

27. Gjykata vëren se parashtruesja e ka parashtruar kërkesën në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

28. Gjykata dëshiron të theksojë se arsyetimi për shterimin e mjeteve juridike është që t’ua lejojë autoriteteve në fjalë, duke përfshirë gjykatat, mundësinë për ta parandaluar ose

korrigjuar shkeljen e supozuar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës do të sigurojë një mjet efikas juridik për shkeljen e të drejtave kushtetuese (shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, Selmouni kundër Francës, Nr. 25803/94, Vendim i 28 korrikut 1999). Megjithatë, nuk është e nevojshme që të drejtat kushtetuese të cekën në mënyrë eksplicite në procedurën në fjalë. Nëse çështja ishte ngritur në mënyrë implicite ose në substancë, rregulli i shterimit të mjeteve juridike është plotësuar (shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, Azinas kundër Qipros, Nr. 56679/00, Vendim i 28 prillit 2004).

29. Duke pasur këtë parasysh, është e qartë se në bazë të dokumentacionit të parashtruar Gjykatës nuk i janë paraqitur dëshmi që parashtruesja i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion të parapara me ligj në përpjekjen e saj që kërkesa t'i miratohet nga Gjykata. Rrjedhimisht, ajo nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj për të parashtruar kërkesë pranë Gjykatës Kushtetuese në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës.
30. Duke pasur parasysh që parashtruesja është përfaqësuar nga një avokat gjatë tërë procedurës, Gjykata mendon që parashtruesja është dashur të ketë qenë në dijeni për të gjitha mjetet juridike që i ka pasur në dispozicion.
31. Pas shqyrtimit të të gjitha fakteve dhe dëshmive të paraqitura, dhe pas këshillimit në lidhje me këtë rast, më 30 prill 2010, Kolegji shqyrtues konkludon se parashtruesja nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike që i ka pasur në dispozicion.


PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47.2 të Ligjit dhe rregullin 56.2 të Rregullores së punës, më 30 maj 2011, Gjykata Kushtetuese njëzëri:

VENDOS


- I. **TA HEDHË POSHTË** kërkesën si të papranueshme.
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit.
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari Raportues



Mr. sc. Kadri Kryeziu

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. Dr. Enver Hasani